

*Fëmijët duan të bisedojnë.  
Gjuha është e rëndësishme.  
Ja si ta ndihmoni fëmijën tuaj.*

*Informacione për prindërit dhe kujdestarët*



# Pse është gjuha që nga fillimi kaq e rëndësishme për fëmijët?

**Fëmijët kanë nevojë për gjuhën në çdo kohë dhe kudo. Ata flasin në familje.**

**Ata flasin dhe luajnë me fëmijët e tjerë. Gjuha është e rëndësishme edhe më vonë. Në shkollë dhe në punë.**

**Kjo është arsyeja pse vitet e para të jetës janë shumë të rëndësishme.**

**Mbështetni fëmijën tuaj.**



## **Filmat: Ja si mësojnë të flasin fëmijët tuaj**

**[www.kinder-4.ch](http://www.kinder-4.ch)**

Në këtë faqe interneti të Drejtorisë Arsimore të kantonit të Cyrihut do të gjeni shumë filma. Filmat tregojnë se si fëmijët mësojnë të flasin dhe si mund ta ndihmoni fëmijën tuaj Flisni me fëmijën tuaj - kurdo dhe kudo.



## **Leximi i librave, recitimi i vargjeve**

**[www.interbiblio.ch](http://www.interbiblio.ch)**

Bibliotekat ndërkulturore në Zvicër. Këtu do të gjeni libra në shumë gjuhë nga kultura të ndryshme. Në hartë do të gjeni një bibliotekë pranë jush.



**[www.vers-und-reim.net](http://www.vers-und-reim.net)**

Këtu do të gjeni vargje në gjuhë të ndryshme nga kultura të ndryshme: Për shembull: En ten tini, savaraka tini, savaraka tika taka, bija, baja, buf, trif, traf, truf!



**[www.buchstart.ch](http://www.buchstart.ch)**

Buchstart (Fillimi i librit) – shikimi i librave me fëmijë të vegjël



**[www.sikjm.ch](http://www.sikjm.ch)**

Schenk mir eine Geschichte (Më dhuro një tregim) – tregime në shumë gjuhë

# Çfarë mund të bëni?

## 1. Flisni shpesh me fëmijën tuaj.

Fëmijët kanë nevojë për biseda me të rriturit. Prandaj, flisni me fëmijën tuaj shpesh dhe kudo. Për shembull: kur bëni blerjet, gjatë ngrënies, në tren. Merreni shtruar, edhe për biseda të gjata. Gabimet gjatë të folurit nuk janë ndonjë gjë e madhe. E rëndësishme është: Ju duhe të kuptoni njëri-tjetrin.

## 2. Lëreni fëmijën tuaj të flasë me fëmijët e tjerë.

Fëmijët mësojnë shumë gjatë lojës, duke përfshirë të folurin. Prandaj dhe kanë nevojë për kontakt me fëmijët e tjerë. Lëreni fëmijën të luajë me fëmijët e tjerë. Jepini fëmijës kohë për të luajtur dhe për të mësuar.

## 3. Dëgjojeni me kujdes fëmijën tuaj.

Fëmijët duan të na tregojnë diçka. Prandaj dhe u pëlqen të flasin me ne. Jepini fëmijës kohë për të folur. Dëgjojeni me kujdes fëmijën tuaj. Tregoni interes dhe bëni pyetje. Kjo do t'ju lejojë ta kuptoni më mirë fëmijën.

## 4. Përdorni gjuhën për gjithçka.

Me gjuhën mund të bëni shumë gjëra, për shembull: të tregoni diçka, të krijoni një histori, të sqaroni botën. Flisni për gjëra interesante për fëmijët. Flisni edhe për ndjenjat. Bëjeni këtë pa u ngutur. Një bisedë e gjatë është e vyer për fëmijën tuaj.

## 5. Shpjegojani fëmijës tuaj shkrimin.

Kudo ka shkronja, numra dhe foto: në libra, në celular, në TV, në tabela. Shpjegojani këto gjëra fëmijës tuaj. Shikoni së bashku libra ose filma për fëmijë. Flisni për to. Kjo do ta ndihmojë fëmijën më vonë në shkollë dhe në botën e sotme digjitale.

## 6. Flisni gjuhën që zotëroni më mirë.

Në shtëpi, flisni gjuhën që zotëroni më mirë me fëmijën tuaj. Në grupin e të vegjëlve, grupet e lojërave ose të çerdhes, fëmija flet gjermanisht. Kështu fëmija juaj mëson dy gjuhë. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për fëmijën tuaj. Kjo e ndihmon më vonë në kopsht dhe në shkollë. Lëreni fëmijën tuaj të luajë herët me fëmijë gjermanishtfolës. Flisni gjuhën që zotëroni më mirë me fëmijën tuaj.

### **A keni ndonjë pyetje?**

Pyesni te grupi i lojërave, grupi i vogëlushëve ose konsulentët për prindërit në komunitetin tuaj. Specialistët do t'ju ndihmojnë me kënaqësi.

Për më shumë informacioni, kontaktoni me Koordinationsstelle Familienfragen (qendrën e koordinimit për çështjet familjare).

Email: [familienfragen@ddi.so.ch](mailto:familienfragen@ddi.so.ch), Tel. 032 627 22 85  
Ne na gjeni te: [so.ch/fruehe-foerderung](http://so.ch/fruehe-foerderung)



Bazat:

**Shkolla e Lartë Pedagogjike Thurgau**  
Mësimdhënia, arsimi i avancuar, kërkimet

Me mbështetjen bujare të:

**Kantonit të Cyrihut, Drejtoria Arsimore**

